



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Integritime Evropiane
Mbledhja nr. 19
Prishtinë, më 18. 11. 2008, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I mbledhjes së Komisionit për Integritime Evropiane

Në mbledhje morën pjesë: Zylfije Hundozi, Bujar Bukoshi, Džezair Murati, Edita Tahiri, Fatmir Rexhepi, Njomza Emini, Nait Hasani, Naser Rugova, ndërsa munguan Hydajet Hyseni, Sabri Hamiti dhe Branislav Grbić.

Pjesëmarrës të tjerë: Blerim Vela - OSBE, Isuf Zejna - KDI, Driton Selmanaj - KDI, Avni Zuka - NDI, Rrahmon Salihu - AIE dhe Frida Wunschmann - ECLO.

I ftuar: zv.kryeministri, Hajredin Kuçi.

Nga stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha dhe Adelina Demolli.

Mbledhjen e kryesoi Zylfije Hundozi - kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Prezantimi i Raportit të progresit nga ana e zv.kryeministrit, z. Hajredin Kuçi,**
- 3. Të ndryshme.**

Kryesuesja konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen për shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Prezantimi i Raportit të progresit nga ana e zv.kryeministrit, z. Hajredin Kuçi

Zylfije Hundozi - Deshi ta dinte se cilat janë planet dhe veprimet e Qeverisë për këtë vit, pasi pritet që në vitin e ardhshëm të bëhet studimi i fizibilitetit. Shtoi se në bazë të Raportit shihet se nuk ka ndonjë përparim nga vitit i kaluar. Pyeti, pse nuk është caktuar deri më tani koordinatori nacional për IPA-në dhe sa ka mundësi të bëhet decentralizimi i kontrollit të IPA-së nga ana e Qeverisë, në mënyrë që të përmirësohen dhe të kanalizohen ashtu si duhet këto mjete? Si çështje të tjera i shtroi: reformimin e administratës publike dhe mungesën e stafit të kualifikuar në Agjencinë për Integritet Evropian. Shtoi se edhe pse nga ana e Komisionit janë bërë vërejtje për këto çështje, nga Raporti shihet se nuk është ndërmarrë asgjë.

Hajredin Kuçi - Tha se jeni të informuar për qëndrimin e Qeverisë rreth Raportit, si raport real. Si arritje në këtë raport janë cekur: menaxhimi i mirë i situatës politike dhe i sigurisë, menaxhimi i mirë i të drejtave të minoriteteve, si dhe bashkëpunimi rajonal. Sfidë e kemi paraparë koordinimin më të mirë ndërmjet institucioneve të Kosovës - në formë ndërveprimi ndërmjet tri shtyllave të pushtetit. Sa i përket gjyqësorit kemi moskoordinim të plotë me të, por shtoi se e kemi respektuar pavarësinë e tij dhe do ta respektojmë edhe në të ardhmen. Disa agjenci në emër të pavarësisë së tyre, në momente të caktuara, i kanë ikur llogaridhënies. Sa i përket sfidës për funksionim të rendit dhe të ligjit, i kemi identifikuar tre faktorë, që janë: Qeveria që do t'i kryejë të gjitha obligimet duke e ndërtuar bazën juridike; qytetarët, që duhet ta rritin bashkëpunimin e tyre me institucionet dhe gjyqësori. Tha se kemi gjyqësor profesional, por nuk është efektiv. Mendojmë se janë tri rrethana që nuk na e kanë lejuar efektivitetin e plotë, si në objektivat politike, ekonomike ashtu edhe në standardet evropiane, si: koha e zgjedhjeve dhe koha e ndërrimit nga një qeveri në tjetrën, përqendrimi për pavarësi e akte themelore dhe faza e transicionit. Hapat e ndërmarrë deri më tani për Raportin janë qëndrimi i Qeverisë lidhur me Raportin, pjesëmarrja në debatet e organizuara nga shoqëria civile, obligimi i ministrave që ta shqyrtojnë Raportin dhe në mbledhjen e ardhshme të Qeverisë të diskutohet për të. Njoftoi se më 2 dhjetor do të mbahet takimi i radhës së Mekanizmit të Stabilizimit Asocimit. Sa i përket emërimit të koordinatorit për IPA-në, e kemi emëruar Besfort Rrecajn. Lidhur me stafin e Agjencisë për Integritet Evropian kemi mungesë të kuadrit për shkak të konkurrencës së rrogave. Tani studentët që kanë marrë bursë nga Qeveria e Kosovës janë të obliguar që pasi të kthehen nga studimet të punojnë dy vjet për Qeverinë e Kosovës. Në të kundërtën janë të obliguar t'i kthejnë të hollat me të cilat u është paguar shkollimi. Lidhur me reformat në administratën publike i kemi dy projekte, me anë të të cilave, në radhë të parë do të bëhet rishikimi i administratës ekzistuese.

Zylfije Hundozi - Lidhur me IPA-në pyeti sa kemi mundësi të kemi qasje në fondet e IPA-së, pasi ato janë fonde që duhet të shfrytëzohen për përparimin e Kosovës dhe për ecjen e saj drejt integriteteve evropiane, në mënyrë që edhe ne si Komision të marrim pjesë në kontrollin dhe menaxhimin e këtyre mjeteve.

Hajredin Kuçi - Tha se mund të marrim pjesë vetëm në përzgjedhjen e projekteve, sepse menaxhimin e tyre e bën Komisioni Evropian. Premtoi se para definimit përfundimtar do ta sjellë një draft, në të cilin mund të shihen se cilat projekte janë caktuar me prioritetet.

Naser Rugova - Më vjen mirë se Qeveria e ka kuptuar seriozitetin e vlerësimit të Raportit të progresit. Sa u përket kritikave tek objektivat politikë ka vërejtje në imponimin e agjendës së Kuvendit nga ana e Qeverisë. Shtoi se jemi republikë parlamentare në të cilën Kuvendi e ka rolin e vet dhe sipas Kushtetutës është institucioni më i lartë legjislativ i vendit. Sa u përket sfidave të paraqitura nga Qeveria, ato vërtet janë çështje që s'mund të rregullohen për një vit, sepse u kanë marrë shumë kohë edhe vendeve që nuk kanë qenë në shtetformim. Sa i përket reformimit të administratës shprehet të dyfishimi i zyrave pranë Zyrës së Kryeministrit, që marrin kohë dhe shkaktojnë konfuzion. Shtoi se është e pajustificueshëm mosfunksionimi i Këshillit të Lartë për Emërime. Në më shumë se 60% të ministrive, ushtrues detyre të sekretarëve janë ish-këshilltarët e ministrave. Me këtë kemi politizim të gjendjes. Është e papranueshme se në borde shumë të rëndësishme partitë e koalicionit dërgojnë nënkryetarë partie. Po ashtu e kemi emërimin e drejtorit të Aeroportit. Sa u përket ligjeve tha se Ministria e Drejtësisë duhet të jetë shembull se si duhet të hartohet një ligj, ndërsa te ne nga Ministria e Drejtësisë vijnë ligje me gabime shumë të mëdha. Është koha e fundit që Kosova të hiqet nga listat e trafikimit të qenieve njerëzore, pasi ekzistojnë mekanizma shumë të përgatitur për luftimin e kësaj dukurie. Sa i përket Agjencisë së Antikorrupsionit, buxheti nuk i është rritur as për një cent. Lidhur me ndikimin e politikës në media është shqetësuese, ashtu siç është shqetësuese ngulfatja e çdo propozimi të opozitës në Kuvend. Ndërsa për barazinë gjinore Qeveria duhet të ndërhyjë dhe të marrë hapa konkretë. Procesi i integriteteve është një sfidë e madhe, andaj mos ngurroni të kërkonit fonde.

Njomza Emiri - Nuk kemi diçka konkrete të prezantuar nga ana e Qeverisë për luftimin e korrupsionit, edhe pse Qeveria ka proklamuar zero tolerancë për korrupsionin. Pyeti se e kujt mbetet përgjegjësia për ato dikastere, në të cilat kompetencat kanë qenë të rezervuara dhe a keni strategji për luftimin e korrupsionit?

Edita Tahiri – Tha se procesi i qeverisjes në Kosovë ka qenë i ngarkuar me çështjet që kanë pasur prioritet më të madh. Kjo e ka ngarkuar agjendën e Qeverisë në raport me një shtet normal. Lidhur me Raportin tha se nuk kemi pritur një raport të shkëlqyeshëm, por disa aspekte janë shqetësuese. Për mua më shqetësueset janë korrupsioni dhe krimi i organizuar, sepse veçmas PDK-ja, në periudhën kur ka qenë opozitë ka disponuar një dosje të korrupsionit, që unë kam menduar se me ardhjen në pushtet do të nisë zbatimin e masave kundër korrupsionit. Korrupsioni duhet të luftohet ndër ata që janë pasuruar menjëherë. Për ta e di edhe populli, kurse institucionet duhet të dinë dy herë më shumë. Pasi të luftohet korrupsioni i qeverive të kaluara edhe kjo Qeveri duhet ta ketë parasysh se mund të dështojë dhe t'i konfiskohet pasuria. Në këtë mënyrë do të merret mësim nga e kaluara. Njoftoi se në të kaluarën ka pasur disa analiza në bazë të të cilave kanë ardhur në përfundim se një numër i madh i shteteve kanë dështuar për shkak të korrupsionit. Shtoi se korrupsioni më së shumti paraqitet në linjat e prokurimit. Kërkoj të hartohet strategjia kundër korrupsionit, për shkak se një gjë e tillë nuk ekziston. Sa i përket gjyqësisë mund të bëhet më shumë, sepse drejtësia s'e ka dhënë fjalën e vet për shumë sfida. Sa u përket integriteteve evropiane tha se mungon njëshi i IPA-së për Kosovën dhe kërkoj më shumë buxhet dhe ndihmë për Komisionin për Integritete Evropiane, sepse në Kuvend ka pasur subordinim, me ç'rast Komisionin për Punë të Jashtme është bërë më i

rëndësishmi. Në vendet e tjera ka mekanizma për koordinimin e udhëtimeve, por jo që një komision t'i sundojë të tjerët. Propozoi që Komisioni së bashku me Qeverinë ta iniciojë një debat në Kuvendin e Kosovës me temën: Fuqizimi i përpjekjeve për Integritimeve Euro-Atlantike.

Nait Hasani - Mendon se duhet të forcohet lufta kundër korrupsionit. Disa veprime që janë bërë kohën e fundit do të jenë shembull për luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, por kjo varet prej nesh, prej guximit të qytetarëve dhe nga Kuvendi. Nëse ne dalim me fakte se ka korrupsion, nuk kanë arsye të heshtin Qeveria dhe policia. Te ne nuk funksionon sistemi i gjyqësisë. E kemi Ministrinë e Drejtësisë, por është çështje e saj pse nuk punon. Sa u përket prokurimeve është e vërtetë se kanë qenë të organizuara në vija familjare, porse tani gjendja ka ndryshuar. Sa i përket planit gjashtëpikësh më jep shpresë qëndrimi i kryetarit dhe kryeministrit, se nuk tërhiqen nga qëndrimi ynë. Gabohemi nëse mendojmë se do ta kalojmë këtë krizë dhe shpëtuam, sepse vazhdimisht do të na vijnë provokime të tilla. Ne e kemi miratuar Kushtetutën dhe askush nuk ka të drejtë ta shkelë atë.

Dzezair Murati - Falënderoi z. Kuçi, sepse gjithmonë gjen kohë t'i përgjigjet ftesës së Komisionit dhe mendon se është adresë e duhur që si përfaqësues i komunitetit të vet t'i shtrojë disa probleme. Tha se çdoherë flitet se po luftohet korrupsioni, por lëvizje në këtë drejtim nuk ka. Ka 6 muaj që në Jugun e Kosovës, në Gorë, po shohim se si po formohet komuna paralele. I kam njoftuar edhe ministrin e Pushtetit Lokal dhe Qeverinë se çka ka ndodhur, por askund nuk kam gjetur mirëkuptim. E kemi ftuar ka 6 muaj ministrin e Arsimit të vinte në Gorë që t'i largonim nga shkolla arsimtarët që nuk i nënshkruajnë kontratat. Në Cyrih e kemi një pjesëtar të komunitetit boshnjak që ka doktoruar në Amerikë për ekonomi. Nëse merremi vesh me të, mund të ndihmojë shumë si këshilltar në Kabinetin e kryeministrit ose në Ministrinë për Ekonomi dhe Financa. Në këtë fazë mund të vijë së paku një herë në muaj dhe t'i paguhet vetëm bileta e udhëtimit me aeroplan. Vetë na është ofruar dhe kemi nevojë për ekspert të tillë. Në vazhdim e kritikoi Ministrinë e Kthimit. Tha se në Qeverinë e Kosovës kjo ministri është vrimë e zezë, sepse kuadrot i ka të pakualifikuara dhe me lidhje farefisnie - është ndërruar ministri, por situata ka mbetur e njëjtë. Disa gjëra i kuptoj me vështirësi dhe mund të bëhen për shkaqe objektive, por disa gjëra subjektive mund të rregullohen me pak lëvizje. Prandaj është dashur që ju, zv.kryeministër, të na i pranoni përfaqësuesit e komuniteteve që nga Ministria për Kthim t'i hiqim ata njerëz, sepse aty është si në stacion autobusësh, ku mund të hyjë dhe dalë kush të dojë dhe nuk ka kurrfarë rendi. Po ju njoftojmë me kohë se çka po na ndodh, por askush s'po na ndihmon. Ju kuptoj se jeni i zënë, por nuk e kuptoj ministrin e Pushtetit Lokal që e ftojme ka 6 muaj të shkojmë atje, sepse po na formohet komuna paralele, por nuk është bërë asgjë. Ne nuk mund vetëm të shikojmë se çka po ndodh, sepse bëhemi qesharakë para njerëzve tanë. Dikush duhet të bisedojë me ne që të bëhen disa lëvizje, aty ku duhet, sepse shumë gjëra duhet të lëvizin që të mos kemi vërejtje si këto në raport. Na ndihmoni, sepse ne jemi të gatshëm ta ndërpresim atë që po ndodh në Jugun e Kosovës.

Fatmir Rexhepi - Tha s'mund të kemi përparim në rrugën e integritimeve përderisa Qeveria nuk e zbaton Kushtetutën. Edhe ngjarjet e fundit do të lënë pasoja politike. Ka

pasur propozime që lidhur me këtë çështje të debatohet menjëherë pas miratimit të Kushtetutës, sepse mesazhi i Kuvendit do të ishte më i fuqishëm, por gabimi më i madh është i Qeverisë. Ministria e Punëve të Jashtme e ka bërë shumë apolitike këtë çështje, vonesa e së cilës do të na kushtojë shumë. Shtoi se vetëkënaqësia do të ketë pasoja shumë të mëdha. Në planin diplomatik Ministria e Punëve të Jashtme ka qenë shumë e mangët, sidomos në planin me OKB-në dhe me zbatimin e Kushtetutës. Nuk i pranoj justifikimet as për Qeverinë, as për Kuvendin. Lidhur me përparimin e arritur, edhe pse në kohën e Qeverisë së Agim Çekut, nuk kemi pasur kompetenca në të gjitha fushat, të arriturat kanë qenë shumë më të mëdha. Lidhur me luftimin e korrupsionit tha se vullneti nuk është masë për ta luftuar, por rezultati. Lidhur me korrupsionin nuk ishin imune as qeveritë e kaluara. Ka mundësi për punë të mira, por ka pak performansë. Nëse vazhdojmë me këtë trend të punës, jam i bindur se pas katër vjetësh do ta zëmë vendin e parë për korrupsion në Ballkan.

Zylfije Hundozi - Tha se pas diskutimit tuaj m'u kujtua metafora se ligji është rrjetë e merimangës vetëm për shtazë të vogla, sepse ato të mëdhatë shkelin mbi të.

Bujar Bukoshi – Sipas kësaj që u diskutua mund të nxirren konkluzione shumë të mira. Nuk duhet lejuar që në Kuvend të kemi subordinim. Glorifikimi s' duhet të ekzistojë, pasi jemi republikë parlamentare, prandaj edhe zv.kryeministri duhet të vijë. Këtë po e them për shkak se në mbledhjen e kaluar nuk na erdhi ministri i Ekonomisë dhe i Financave. E përkrahu çështjen që e ngriti deputeti Dzezair Murati, sepse ka të bëjë me shtetformimin e Kosovës. Pyeti, cila është super-sfidë për Qeverinë? Nëse një Komision parlamentar me Qeverinë has në një propozim që vjen nga ndërkombëtarët, me të cilin cenohet pavarësia, atëherë a po integrohet Kosova si shtet, lagje apo krahinë? Propozimi i fundit në thelb po tenton ta anulojë pavarësinë e Kosovës, ndërsa disponimi i gjithë popullsisë është për anulimin dhe refuzimin, por me këtë rast mos po e humbim mbështetjen e ndërkombëtarëve, sepse nëse lejojmë të ndodhë kjo, ne po e legjitimojmë ndarjen dhe po e humbim integritetin territorial.

Zylfije Hundozi - Pashë se i kishit identifikuar 99 sfida, por ndër to nuk pashë të paraqitur asgjë për kooperimin rajonal, që është njëri ndër kushtet për integrime evropiane. I pyeti se a keni caktuar ndonjë përfaqësues për CEFTA-n, sepse ende po përfaqësohemi nga UNMIK-u, si dhe për integrimin në marrëveshjet rajonale për energji, si çështje shumë me rëndësi. A nuk mendoni se shteti i Kosovës duhet të jetë garantues për zbatimin e ligjit, sepse njerëzit e thjeshtë s'mund ta sigurojnë zbatimin e tij?

Hajredin Kuçi - Tha se raporti është i hartuar për të gjitha institucionet e Kosovës. Kosova merr pjesë aktivisht në takimet rajonale, andaj kjo çështje është futur në listën e të arriturave. Lidhur me përfaqësuesin për CEFTA-n, është caktuar ministri i Tregtisë dhe i Industrisë, z. Lutfi Zharku. Lidhur me mospjesëmarrjen e ministrit të Ekonomisë në mbledhje, tha se kemi bërë vërejtje dhe besoj se do ta korrigjojë gabimin e vet. Lidhur me çështjet që i parashtrioi deputeti Rugova, tha se për shkak që shpeshherë nën presionin e ndërkombëtarëve është dashur të caktohen shumë çështje, kjo ka mund të dukej edhe si imponim i agjendës. Shtoi se kryeministri është edhe kryetar i kryetarit të Kuvendit, sepse për herë të parë Qeveria udhëhiqet nga partia që e ka fituar shumicën e votave. Sa i

përket dyfishimit të zyrave, Ligji për Qeverinë do ta saktësojë dhe do ta rregullojë këtë çështje. Lidhur me Ministrinë e Drejtësisë fatkeqësisht ka lëshime të mëdha, por është mirë që shpeshherë janë kthyer disa ligje nga Kuvendi. Sa i përket miratimit të buxhetit për Agjencinë Antikorrupsion tha se i është miratuar buxheti 100%, aq sa e ka kërkuar. E kemi miratuar strategjinë për luftimin e trafikut të qenieve njerëzore. Sa u përket doganave nuk kemi pasur asnjë kompetencë për to. Buxhetin për polici e kemi kaluar në Ministrinë e Brendshme. Ndikimi i politikës në media bëhet nga të gjitha partitë politike dhe jo nga Qeveria. Deri më tani nuk kemi asnjë gazetar që ka dalë dhe ka thënë se jam i kërcënuar. Kërkoj që në të njëjtën mënyrë të zbatohet edhe Ligji kundër shpifjeve. Sa për barazinë gjinore kemi ligje shumë të mira, por nuk po zbatohen. Sa i përket strategjisë për luftimin e krimit dhe të terrorizmit e kemi miratuar strategjinë në mbledhjen e kaluar të Qeverisë. Sa i përket rastit të arrestimit të punëtorëve shëndetësorë edhe ne jemi njoftuar me anë të mediave. Kemi pasur kujdes të mos i largojmë nga vendet e punës për shkak se do të interpretohej si hakmarrje. Sa i përket gjyqësisë ajo është jashtë duarve tona dhe kështu do të jetë si në çdo vend demokratik. Shtoi se në të ardhmen do të kemi probleme të mëdha me bartjen e pronave. Lidhur me Komisionin për Integritet Evropian tha se do ta keni mbështetjen buxhetore të Qeverisë, ndërsa për hierarkinë brenda institucionit nuk mund të ndërhyjmë. Jemi të gatshëm të organizojmë debate, por s'mund t'i iniciojmë. Si supersfidë është sundimi i rendit dhe i ligjit, sepse me funksionimin e rendit dhe të ligjit do të funksionojnë ekonomia dhe drejtësia. Sa i përket dokumentit gjashtëpikësh është paraqitur para dhjetë ditësh tek institucionet e Kosovës, si marrëveshje e EULEX-it me Beogradin. E dimë se në hapat e mëtejshëm s'mund të bëjmë pa përkrahjen e ndërkombëtarëve. Çështjen e një komune dhe zyre që e përmendi z. Dzezair, e kemi dhënë pëlqimin për heqjen, por e kemi pasur reagimin e z. Pieter Feith. Për shkak të mostensionimit nuk kemi këmbëngulur më shumë. Sovranitetin nuk mund ta bartin vetëm dy veta. Nëse krijohet një gjendje e tillë, do të jetë Kuvendi ai që do të merret me këtë.

Fatmir Rexhepi - Unë së paku nuk e shpreha pakënaqësinë time, por mendimin si kisha dashur ta shoh Qeverinë. Sa i përket luftës kundër korrupsionit, nuk di nëse duhen më shumë fakte për kompanitë publike. Më vjen keq për atë që po ndodh në shëndetësi, për dramën që i bënë. Keni bërë spektakël arrestimin e punëtorëve shëndetësorë përderisa maunat me naftë sillen nëpër Kosovë pa asnjë kontroll. Nëse Qeveria do ta luftojë korrupsionin, e ka mbështetjen. Nuk e ndaj mendimin e njëjtë për atë se Qeveria deri tani nuk ka ditur për planin gjashtëpikësh. Është dashur të mbrohet Kushtetuta më herët, jo tani të kërkohet nga qytetarët ta mbrojnë Kushtetutën.

Naser Rugova - Lidhur me pronat dhe me lëndët civile e lus zv.kryeministrin që ta procedojë sa më parë Ligjin për prona, sepse është koha e fundit ta kemi këtë ligj me anën e të cilit do të ndihmohej edhe procesi i privatizimit.

Zylfije Hundozi – E falënderoi zv.kryeministrin për paraqitjen dhe tha se kemi dashur që nëpërmjet kësaj të ndihmojmë edhe ne sado pak në çështjen e integriteteve.

3) Të ndryshme

Propozimi i NDI-së

Kryesuesja - I njoftoi anëtarët e Komisionit se NDI-ja i ka lejuar mjetet që të organizohet dëgjim publik dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të paraqesin ide dhe propozime për temën dhe kohën e organizimit të dëgjimit publik.

Pas diskutimeve të deputetëve u nxor ky

Përfundim

Dëgjimi të organizohet me 10 - 12 dhjetor dhe të jetë rekapitullim i punës së Komisionit për Integritet Evropian.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20 min.

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit

Zylfije Hundozi